

RIT Kosovë (A.U.K)  
Programet Universitare  
Udhëzues i Shkurtë

Për ta fituar diplomën Bachelor në RIT Kosovë (A.U.K), studenti duhet:

1. Të përfundoj dy nga pesë **Drejtimit Kryesore Profesionale** (zgjedhni dy):

- a. Ekonomi dhe Statistika
- b. Menaxhment dhe Ndërmarrësi
- c. Politika Publike dhe Qeverisje
- d. Dizajn Grafik dhe Multimedia
- e. Ueb dhe Informatikë Mobile (TI)
- f. Të tjera (përmes këmbimit ose studimeve jashtë vendit)

2. Të përfundoj kërkesat e **Arsimit të Përgjithshëm** (detajet mund t'i gjeni në këtë udhëzues)

Opsionet për të studiuar në një ose më shumë kampuse globale të RIT-së:

1. Kinë
2. Kroaci (Zagreb dhe Dubrovnik)
3. Dubai
4. Kosovë
5. Nju Jork
6. Të tjera (këmbimi përmes Erasmus ose Institucioneve partnere)

## **PËRSHKRIMI I DIPLOMAVE DHE DREJTIMEVE**

RIT Kosovë (A.U.K) ofron diplomë amerikane me përgatitje inovative, të përshtatur dhe kreative që pajis studentët me aftësi profesionale dhe jetësore për një botë globale. Instituti Rochester i Teknologjisë, partneri i dhënies së diplomave i RIT Kosovë (A.U.K), u ofron studentëve mundësinë për të krijuar programe universitare nga dy ose më shumë fusha profesionale të studimit me një themel të fortë në shkencë shoqërore, përmes Shkollës inovative të Studimeve të Individualizuara të RIT. Në Kosovë, këto fusha profesionale të studimit janë Menaxhimi dhe Ndërmarrësia, Ekonomia dhe Statistikat, Politika Publike dhe Qeverisja, Dizajni Grafik dhe Multimedia, si dhe oferta jonë më e re Ueb dhe Informatike Mobile (TI). Studentët mund të fitojnë Diplomë Associate me studime dyvjeçare ose Diplomë Bachelor në Arte dhe Shkencë të Aplikuara nga Shkolla e Studimeve të Individualizuara në lokacionin tonë në Kosovë. Në programet tona universitare, studentët punojnë ngushtë me profesorët dhe këshilltarët profesionalë për të hartuar plane unike dhe shumëdisiplinore të studimit, duke i kombinuar disa fusha të njohurive dhe interesave akademike. Programi i arteve dhe shkencave të aplikuara është veçanërisht i përshtatshëm për individët që duan të përgatiten për një karrierë që kërkon aftësi dhe ekspertizë nga disa disiplina. Ky mjedis i përzier mësimor siguron një bazë të fortë për studentët në Kosovë, rajon dhe në mbarë botën për të mësuar dhe praktikuar shkathtësitë e të menduarit kritik, lidërsipit dhe komunikimit në disiplina të ndryshme, duke fituar njohuri teknike në fushat e studimit profesional që i përshtaten më mirë individit. Përveç këtyre orientimeve profesionale të ofruara në Kosovë, studentët mund të zgjedhin të kryejnë një semestër ose një vit jashtë vendit në kampusin e Rochester-it ose në kampuset e tjera globale për t'i kryer lëndët që nuk ofrohen në këtë vend. Shkolla e Studimeve të Individualizuara është gjithashtu një zgjedhje e mirë për ata që kanë ide unike për mënyrën se si dëshirojnë t'i zhvillojnë fushat e tyre akademike të studimit, që kanë informata paraprake të nivelit të kolegjit apo që janë të interesuar në ndryshimin e drejtimit.

## **DIPLOMAT E OFRUARA**

- **Diplomë Associate (AAS) – 2 vite studim**

Titulli i diplomës: Diplomë Associate i Shkencave të Aplikuara (AAS) në Arte dhe Shkenca të Aplikuara

Gjithsej kredite: 60 kredi semestrare

Institucioni dhe departamenti: Instituti Rochester i Teknologjisë; Shkolla e Studimeve të Individualizuara (SOIS)

- **Diplomë Bachelor (BS) – 4 vite studim**

Titulli i diplomës: Diplomë Bachelor i Shkencës (BS) në Arte dhe Shkenca Aplikative

Gjithsej kredite: 120 kredi semestrare

Institucioni dhe departamenti: Instituti Rochester i Teknologjisë; Shkolla e Studimeve të Individualizuara (SOIS)

### **Këto diploma fitohen përmes studimit në fushat vijuese:**

1. **Përqendrimi në (fushat e studimit)(zgjidh dy):** Ekonomi dhe Statistika, Menaxhment dhe Ndërmarrësi, Politika Publike dhe Qeverisje, Dizajn Grafik dhe Multimedia, Ueb dhe Informatikë Mobile (TI)
2. **Arsim i përgjithshëm (Shkenca sociale)**
3. **Drejtimi sekondar (opsional)**

## **DREJTIMET KRYESORE (Fushat e studimit) (zgjedhni dy)**

### **Drejtimi në UEB DHE INFORMATIKË MOBILE (TI) (24 kredite)**

Drejtimi Ueb dhe Informatikë Mobile (TI) vë theksin në bazat e informatikës së aplikuar dhe zhvillimit të uebit. Uebi është bërë mediumi më i përhapur i komunikimit. Prandaj njohuritë mbi funksionimin e internetit dhe si të zhvillohen në mënyrë efektive faqet dinamike të internetit kanë vlerë për studentët e regjistruar në shumë fusha të përqendrimit dhe me qëllime të ndryshme të karrierës. Pas përfundimit të këtij përqendrimi, studentët do të kenë një varg të gjerë shkathësisht dhe të kuptuarit të nevojshëm për të hartuar dhe ndërtuar një prani themelore, por të plotë në ueb, në fushën tuaj të përzgjedhur të interesit. Studentët gjithashtu do të kuptojnë si t'i përdorin multimediat dhe të krijojnë sisteme që mundësojnë ekspertin e fushës ta shfrytëzojë informacionin në dispozicion. Lëndët në këtë përqendrim janë aplikative dhe me fokus në të mësuarit praktik, duke përfshirë projekte që do të jenë të dobishme jashtë mjedisve universitare.

#### **Lëndët:**

ISTE-120	Zgjidhja e problemeve kompjuterike: Domeni informativ I	4 kredite
ISTE-121	Zgjidhja e problemeve kompjuterike: Domeni informativ II	4 kredite
ISTE-131	Matematike diskrete	4 kredite
ISTE-140	Ueb dhe mobil I	3 kredite
ISTE-230	Hyrje në bazën e të dhënave dhe modelim i të dhënave	3 kredite
ISTE-240	Ueb dhe mobil II	3 kredite
ISTE-252	Bazat e dizajnit mobil	3 kredite
ISTE-260	Dizajnim i përvojës së përdoruesit	3 kredite
ISTE-340	Programim i klientit	3 kredite

## **DREJTIMET KRYESORE (vazhdim)**

### **Drejtimi DIZAJN GRAFIK DHE MULTIMEDIA (24 kredite)**

Drejtimi Dizajn Grafik dhe Multimedia kombinon komunikimin bashkëkohor vizual dhe teorinë dhe mjetet multimediale për t'i përgatitur studentët për komunikim efektiv në një larmi mediash. Sekuenca e lëndëve përgatitë studentët me aspekte praktike dhe teorike të dizajnit grafik, zhvillimit të uebit, dizajnit të printimit dhe prodhimit multimedial, teknikave të komunikimit dhe menaxhimit të aseteve digjitale. Një student që përfundon përqendrimin e Dizajnit Grafik dhe Multimedias përgatitet me kornizën teorike dhe shkathtësitë teknike të nevojshme për të organizuar, dizajnuar dhe komunikuar idetë dhe informacionet në tregun global të shekullit 21 dhe për t'i përmbushur nevojat e parashikuara të tregut kombëtar në rajonin më të madh të Kosovës. Është gjithashtu një përmbledhje e shkëlqyer e ofertave të tjera të përqendrimeve në RIT Kosovë (A.U.K) dhe ofron një numër shkathtësish të dobishme për bizneset private dhe familjare.

#### **Lëndët:**

COMM – 223	Dizajn digjital në komunikim	3 kredite
TCOM – 270	Ueb-dizajn efektiv 1	3 kredite
TCOM – 271	Ueb-dizajn efektiv 2	3 kredite
TCOM – 365	Video-produksion	3 kredite
TCOM – 380	Dizajn për print dhe ueb	3 kredite
TCOM – 381	Foto-imazhim I	3 kredite
TCOM – 382	Foto-imazhim II	3 kredite
TCOM – 383	Dizajnim i grafikave vektor	3 kredite

## **DREJTIMET KRYESORE (vazhdim)**

### **Drejtimi MENAXHMENT dhe NDËRMARRËSI (24 kredite)**

Drejtimi i Menaxhmentit përgatitë nxënësit për menaxhment dhe karrierë të specialistit në një numër ndërmarrjesh dhe organizatash. Studentët zhvillojnë shkathtësitë dhe konceptet e nevojshme për t'u bërë udhëheqës efektivë, vendimmarrës etikë dhe inovatorë kreativë. Kurrikula e menaxhmentit siguron thellësi dhe fleksibilitet në ofertat e saj ashtu që studentët maksimizojnë përvojën e tyre arsimore.

#### **Lëndët e obligueshme:**

BUSI – 205	Menaxhim i fuqisë punëtore	3 kredite
ACBS – 201	Kontabilitet financiar	3 kredite
ACBS – 203	Kontabilitet menaxherial	3 kredite

#### **Lëndët zgjedhore:**

ACBS – 353	Shkenca e menaxhmentit	3 kredite
BUSI – 221	Zhvillimi i ndërmarrjeve të reja	3 kredite
BUSI – 263	Parimet e reklamimit	3 kredite
BUSI – 361	Parimet e marketingut	3 kredite
HRDE – 386	Menaxhim i burimeve njerëzore	3 kredite
BUSI – 410	Menaxhim i projekteve	3 kredite
BUSI – 450	Hyrje në logjistikë dhe transport	3 kredite

## **DREJTIMET KRYESORE (vazhdim)**

### **Drejtimi POLITIKA PUBLIKE dhe QEVERISJE (24 kredite)**

Drejtimi Politika Publike dhe Qeverisje u siguron studentëve një kuptim të qartë të politikës publike, procesit të politikave dhe analizës së politikave. Studentët kanë mundësinë të zhvillojnë perspektiva për një sërë çështjesh të politikave bashkëkohore publike, veçanërisht atyre që dalin nga avancimet shkencore dhe teknologjike. Studentëve u prezantohet koncepti i politikës publike dhe procesit të politikëbërjes dhe metodologjitë e lidhura me analizën e politikave. Rolet e hisedarëve dhe grupeve të interesit diskutohen në kontekstin e rasteve bashkëkohore në arena të ndryshme të politikave.

#### **Lëndët e obligueshme:**

PUBL – 101 Bazat e politikës publike 3 kredite

#### **Lëndët zgjedhore:**

PUBL – 201 Etika, vlerat dhe politikat publike 3 kredite

STSO – 201 Politika e shkencës dhe teknologjisë 3 kredite

PUBL – 210 Hyrje në analizën cilësore të politikave 3 kredite

POLS – 220 Ekonomi globale politike 3 kredite

PUBL – 301 Analizë e politikave publike 3 kredite

SOCI – 340 Planifikimi urban dhe politikat 3 kredite

POLS – 345 Politika, dhe politika publike 3 kredite

STSO – 421 Politikat mjedisore 3 kredite



## **DREJTIMET KRYESORE (vazhdim)**

### **Drejtimi EKONOMI dhe STATISTIKA (24 kredite)**

Drejtimi i Ekonomisë thekson qasjen sasiore analitike në trajtimin e problemeve ekonomike si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, duke pajisur studentët me shkathtësi të tregtueshme dhe bazë intelektuale për ngritje në karrierë. Të diplomuarit përgatiten për pozita menaxheriale dhe analitike të nivelit hyrës si në industri ashtu dhe në qeveri, si dhe për t'i vijuar studimet pasuniversitare në ekonomi, biznes dhe drejtësi. Kurrikula e ekonomisë zhvillon shkathtësitë e komunikimit, llogaritjes dhe menaxhmentit, krahas arsyeve ekonomike dhe aftësive sasiore. Lëndët e obligueshme të programit zhvillojnë aftësitë e studentëve për të aplikuar analizat ekonomike në problemet e botës reale. Artet liberale avancojnë aftësitë orale të komunikimit si dhe ato të komunikimit në formë të shkruar. Lëndët e biznesit përfshijnë kontabilitet dhe financa. Shkathtësitë analitike sasiore zhvillohen nga një numër orësh, përfshirë shkencat kompjuterike, matematikën dhe statistikat.

#### **Lëndët e obligueshme:**

ECON – 101	Parimet e makroekonomisë	3 kredite
ECON – 201	Parimet e makroekonomisë	3 kredite
ECON – 403	Ekonometria I	3 kredite

#### **Lëndët zgjedhore:**

ECON – 402	Teori e ndërmjetme makroekonomike	3 kredite
ECON – 405	Tregti dhe financa ndërkombëtare	3 kredite
ECON – 421	Ekonomia e burimeve natyrore	3 kredite
ECON – 422	Analiza e benefiteve dhe kostos	3 kredite
ECON – 431	Analiza dhe politika monetare	3 kredite
ECON – 441	Ekonomia e punës	3 kredite
ECON – 444	Financa publike	3 kredite
ECON – 448	Ekonomi zhvillimore	3 kredite
ECON – 520	Ekonomi mjedisore	3 kredite

## **DREJTIMET SEKONDARE**

Në RIT Kosovë (A.U.K), drejtimi sekondar përkufizohet si Lëndët e lidhura tematike që përbëhen nga jo më pak se 15 kredi semestrare të marra nga një disiplinë apo fushë ndërdisiplinore që dallon nga programi primar i studimit të studentit. Përfundimi i një drejtimi sekondar rezulton në përcaktim formal të transkriptit akademik të studentit pas diplomimit. Nëse një student zgjedh të përfundojë një drejtim sekondar, ai duhet të plotësojë formularin për Autorizimin e Drejtimit Sekondar. Mosplotësimi i këtij formulari rezulton me moscertifikim të studentit për drejtimin sekondar dhe moslistimin e drejtimit sekondar në regjistrin zyrtar të studentit.

Aktualisht janë 3 drejtime sekondare të ofruara në RIT Kosovë (A.U.K). Studentët mund të zgjedhin të përfundojnë një drejtim sekondar para diplomimit. Studentët të cilët janë të obliguar të kryejnë mësim intensiv në A.U.K mund t'i marrin dy lëndë shtesë në të njëjtën fushë për të diplomuar me drejtim sekondar.

### **Drejtimi sekondar në EKONOMI (15 kredite)**

Drejtimi sekondar në Ekonomi ofron analizë sistematike të çështjeve ekonomike përmes studimit të ndarjes së burimeve të rralla në prodhim dhe shpërndarje të prodhimit tek pjesëtarët e shoqërisë. Ky drejtim sekondar është i mbyllur për studentët me drejtim kryesor në Ekonomi dhe Statistika.

#### **Lëndët e obligueshme:**

ECON – 101	Parimet e mikroekonomisë	3 kredite
ECON – 201	Parimet e makroekonomisë	3 kredite
ECON – 403	Ekonometri I	3 kredite

#### **Lëndët zgjedhore (zgjedh dy lëndë shtesë):**

ECON – 402	Teori e ndërmjetme makroekonomike	3 kredite
ECON – 405	Tregti dhe financa ndërkombëtare	3 kredite
ECON – 421	Ekonomia e burimeve natyrore	3 kredite
ECON – 422	Analiza e benefiteve dhe kostos	3 kredite
ECON – 431	Analiza dhe politika monetare	3 kredite
ECON – 441	Ekonomia e punës	3 kredite
ECON – 444	Financa publike	3 kredite
ECON – 448	Ekonomi zhvillimore	3 kredite
ECON – 520	Ekonomi mjedisore	3 kredite

## **DREJTIMET SEKONDARE (vazhdim)**

### **Drejtimi sekondar në MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE (15 kredite)**

Drejtimi sekondar në marrëdhënie ndërkombëtare ekspozon studentët në konceptet dhe qasjet themelore të marrëdhënieve ndërkombëtare. Çështjet e konfliktit, bashkëpunimit, vazhdimësisë dhe ndryshimit janë të shpjeguara përmes një varg lëndësh dhe rastesh studimore.

#### **Lëndët e obligueshme:**

POLS – 120 Hyrje në marrëdhënie ndërkombëtare 3 kredite

#### **Lëndët zgjedhore (zgjedh katër lëndë shtesë):**

POLS – 325 E drejta dhe organizatat ndërkombëtare 3 kredite

POLS – 330 Të drejtat e njeriut dhe perspektivat globale 3 kredite

POLS – 335 Politika në shtetet në zhvillim 3 kredite

POLS – 445 Terrorizmi dhe dhuna politike 3 kredite

## **DREJTIMET SEKONDARE (vazhdim)**

### **Drejtimi sekondar në POLITIKA PUBLIKE (15 kredite)**

Drejtimi sekondar në Politika Publike u siguron studentëve një bazë në fushën e politikës publike dhe u mundëson atyre t'i bëjnë lidhjet midis politikave publike dhe fushave të tjera të studimit. Ai shqyrton çështjet bashkëkohore të politikave publike, veçanërisht ato që lidhen me fushat e shkencës dhe teknologjisë. Ky drejtim sekondar është i mbyllur për studentët me drejtim kryesor në Politika Publike dhe Qeverisje.

#### **Lëndët e obligueshme:**

PUBL – 101	Bazat e politikës publike	3 kredite
STSO – 201	Politika e shkencës dhe teknologjisë	3 kredite

#### **Lëndët zgjedhore (zgjedh tri lëndë shtesë):**

PUBL – 210	Hyrje në analizën cilësore të politikave	3 kredite
POLS – 345	Politika, dhe politikat publike	3 kredite
PUBL – 201	Etika, vlerat dhe politikat publike	3 kredite
PUBL – 301	Analizë e politikave publike	3 kredite
STSO – 421	Politika mjedisore	3 kredite

## **ORËT INTENSIVE**

Si pjesë e kërkesave të diplomës së tyre Bachelor, studentët duhet të përfundojnë një zhytje (orë intensive) – përqendrim i tri lëndëve në një fushë të caktuar. Këto lëndë të nivelit të lartë përdoren për t'i përmbushur kërkesat e arsimit të përgjithshëm të RIT. Në shumë raste orët intensive mund të çojnë në drejtim sekondar me shtim prej dy lëndëve. Megjithatë, jo të gjithë drejtimet sekondare kanë orë intensive korresponduese dhe anasjelltas. Në RIT Kosovë (A.U.K) ofrohen katër drejtime të ndryshme intensive.

### **ANGLISHTE intensive (9 kredite)**

Anglishtja intensive u jep studentëve mundësinë që t'i eksplorojnë studimet e Anglishtes në fushën e letërsisë, gjuhësisë dhe shkrimit kreativ. Orët intensive janë fleksibile ashtu që të akomodojnë interesat e studentëve në fushat si periudha historike specifike letrare ose zonat gjeografike, multimediat dhe artet pamore, ose zhanret e fikSIONIT siç janë fantashkenca, fantazia ose romanca. Kurset theksojnë aftësinë për të lexuar literaturë dhe media të reja në mënyrë analitike dhe shkrimin në mënyrë kritike.

#### **Lëndët e obligueshme:**

ENGL-210	Literaturë, kulturë dhe media	3 kredite
----------	-------------------------------	-----------

#### **Lëndët zgjedhore (zgjedh dy lëndë shtesë):**

ENGL-216	Literaturë nga e tërë bota	3 kredite
XXX	DTP	3 kredite
XXX	DTP	3 kredite

## **ORËT INTENSIVE (vazhdim)**

### **Politika Publike intensive (9 kredite)**

Kjo lëndë intensive pajis studentët me një kuptim të qartë të politikës publike, procesit të politikave dhe analizës së politikave. Studentët kanë mundësinë të zhvillojnë perspektivë për një sërë çështjesh të politikave bashkëkohore publike, veçanërisht atyre që dalin nga avancimet shkencore dhe teknologjike. Kjo lëndë intensive është e mbyllur për studentët me drejtim kryesor në Politika Publike dhe Qeverisje.

### **Lëndët zgjedhore (zgjedh tri orë):**

PUBL – 201	Etika, vlerat dhe politikat publike	3 kredite
STSO – 201	Politika e shkencës dhe teknologjisë	3 kredite
PUBL – 301	Analizë e politikave publike	3 kredite
PUBL – 210	Hyrje në analizën cilësore të politikave	3 kredite
POLS – 220	Ekonomi globale politike	3 kredite
PUBL – 301	Analizë e politikave publike	3 kredite
SOCI – 340	Planifikimi urban dhe politikat	3 kredite
POLS – 345	Politika, dhe politika publike	3 kredite
STSO – 421	Politikat mjedisore	3 kredite

PUBL-201	Etika, vlerat dhe politikat publike	3 kredite
STSO-201	Politika e shkencës dhe teknologjisë	3 kredite
PUBL-301	Analizë e politikave publike	3 kredite
PUBL-302	Analizë vendimesh	3 kredite
PUBL-363	Politika dhe e drejta e sigurisë kibernetike	3 kredite
PUBL-510	Inovacioni teknologjik dhe politika publike	3 kredite
PUBL-520	Politika e informacionit dhe komunikimit	3 kredite
PUBL-530	Politika e energjisë	3 kredite
STSO-201	Politika e shkencës dhe teknologjisë	3 kredite
STSO-421	Politika mjedisore	3 kredite

## **ORËT INTENSIVE (vazhdim)**

### **EKONOMI intensive (9 kredite)**

Ekonomia intensive siguron një analizë sistematike të çështjeve ekonomike përmes studimit të ndarjes së burimeve rralla në prodhim dhe shpërndarje të prodhimit tek pjesëtarët e shoqërisë. Ky drejtim intensiv është i mbyllur për studentët me drejtim kryesor në Ekonomi dhe Statistika.

#### **Lëndët e obligueshme:**

ECON – 101 Parimet e mikroekonomisë 3 kredite

#### **Lëndët zgjedhore (zgjedh dy lëndë shtesë):**

ECON – 402 Teori e ndërmjetme makroekonomike 3 kredite

ECON – 405 Tregti dhe financa ndërkombëtare 3 kredite

ECON – 421 Ekonomia e burimeve natyrore 3 kredite

ECON – 422 Analiza e benefiteve dhe kostos 3 kredite

ECON – 431 Analiza dhe politika monetare 3 kredite

ECON – 441 Ekonomia e punës 3 kredite

ECON – 444 Financa publike 3 kredite

ECON – 448 Ekonomi zhvillimore 3 kredite

ECON – 520 Ekonomi mjedisore 3 kredite

## **ORËT INTENSIVE (vazhdim)**

### **MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE intensive (9 kredite)**

Marrëdhëniet ndërkombëtare intensive kombinon studimin e kompleksiteteve dhe trendeve të ndryshueshme të politikës ndërkombëtare me studimin e sistemit global. Theks i veçantë i kushtohet bashkëveprimet dhe ndërlidhjes së shteteve-kombe në nivel ndërkombëtar dhe pjesëmarrësve të tjerë në çështjet ndërkombëtare, siç janë organizatat ndërkombëtare, organizatat joqeveritare, subjektet subnacionale dhe qytetarët individualë. Çështjet globale të studiuara përfshijnë demokratizimin, konfliktet ndërkombëtare dhe rajonale, terrorizmin, tregtinë ndërkombëtare dhe integrimin ekonomik, zhvillimin ekonomik, të drejtën dhe organizatat ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut.

#### **Lëndët zgjedhore (zgjedh tri lëndë):**

POLS – 325	E drejta dhe organizatat ndërkombëtare	3 kredite
POLS – 330	Të drejtat e njeriut dhe perspektivat globale	3 kredite
POLS – 335	Politika në shtetet në zhvillim	3 kredite
POLS – 445	Terrorizmi dhe dhuna politike	3 kredite
POLST – 525	Tema speciale në marrëdhënie ndërkombëtare	3 kredite



## **ARSIMI I PËRGJITHSHËM (ose SHKENCAT SOCIALE) kërkesat (60 orë krediti)**

Puna e lëndës së Arsimit të Përgjithshëm është baza e diplomës amerikane. Lënda është hartuar ashtu që i ofron studentëve mendim kritik, komunikim, shkrim, matematikë, arte dhe shkathtësi të tjera të përgjithshme që janë të nevojshme për lidërsip, sukses dhe inovacion në çdo fushë profesionale. Kjo kornizë u ofron studentëve orë që përmbushin rezultatet specifike të mësim-it të arsimit të përgjithshëm të miratuara dhe kërkesat e Arteve dhe Shkencave Liberale të Departamentit të Arsimit të Shtetit të Nju Jorkut. Kërkesat e diplomës së shkencave sociale kalojnë nëpër tri faza arsimore të dizajnuara për t'i dhënë studentëve një bazë të fortë, hyrje në bazat e disiplinave të arteve dhe shkencave liberale, si dhe mundësi për studim më të thellë dhe mësim integruar nëpërmjet orëve intensive të një grupi lëndësh të lidhura.

### **A. Kërkesat bazë (6 kredite semestrale)**

Dy lëndë në vitin e parë që prezantojnë para studentëve jetën intelektuale të universitetit dhe ofrojnë një fokus në shkathtësitë e komunikimit për t'i përgatitur studentët për lëndët vijuese dhe mësimin tërëjetësor. UWRT-150 FYW: Seminar shkrimi  
ENGL-216 Literaturë nga e tërë bota

### **B. Kërkesat perspektive (24 kredite semestrale)**

Kategoria perspektive paraqet para studentëve fushat e rëndësishme të humlunitit që sigurojnë mënyra për të mësuar për botën. Perspektivat e paraqitura në këtë kategori janë ato etike, artistike, globale, sociale, shkencore dhe matematikore. Numri i krediteve të kërkuara në këtë kategori është 15 orë krediti për Diplomë ASS dhe 24 orë krediti për Diplomë BS.

**1. Perspektiva e ETIKËS:** Lëndët përqendrohen në aspektet etike të vendimmarrjes dhe argumentit, qoftë në nivel individual, grupor, kombëtar apo ndërkombëtar. Këto lëndë u ofrojnë studentëve një kuptim se si mund të konceptohen dhe zgjidhen problemet dhe çështjet etike dhe në çfarë mënyre paraqiten format etike të arsimit dhe si zbatohen në këto sfida.

## **ARSIMI I PËRGJITHSHËM (ose SHKENCAT SOCIALE) (vazhdim)**

**2. Perspektiva e ARTEVE.** Lëndët përqendrohen në analizën e formave të shprehjes artistike në kontekstin e shoqërive dhe kulturave që i kanë prodhuar dhe mbështetur ato. Këto lëndë ofrojnë njohuri për procesin kreativ, natyrën e përvojës estetike, bazat e kritikës dhe diskriminimit estetik, dhe mënyrat në të cilat shoqëritë dhe kulturat shprehin vlerat e tyre përmes artit të tyre.

**3. Perspektiva GLOBALE:** Lëndët në këtë kategori inkurajojnë studentët që ta shohin jetën nga një perspektivë më e gjerë sesa ajo e tyre dhe ta kuptojnë diversitetin e kulturave njerëzore brenda një shoqërie të ndërlidhur globale. Lëndët eksplorojnë ndërlidhjen e botës lokale dhe globale në kohën e sotme ose me shembuj historikë, dhe nxisin studentët që të shohin se si reflektojnë forcat globale në nivel lokal.

**4. Perspektiva SOCIALE:** Lëndët përqendrohen në analizën e sjelljes njerëzore në kontekstin e sistemeve dhe institucioneve sociale. Meqë suksesi i nxënësve varet nga aftësia për të kuptuar se si funksionojnë dhe veprojnë grupet sociale, këto lënë njohuri për punën e proceseve të institucioneve sociale.

**5. Perspektiva e SHKENCAVE NATYRORE:** Shkenca është më shumë se një përmbledhje e fakteve dhe teorive, prandaj studentët pritet ta kuptojnë dhe të marrin pjesë në procesin e kërkimit shkencor. Lëndët përqendrohen në parimet bazë dhe konceptet e një prej shkencave natyrore. Në këto lëndë, studentët aplikojnë metodat e kërkimit shkencor dhe zgjidhjen e problemeve në laborator ose përvojat në terren.

**6. Perspektiva e PARIMEVE SHKENCORE:** Lëndët përqendrohen në parimet themelore të një shkence natyrore ose ofrojnë mundësi për aplikimin e metodave të kërkimit shkencor në shkenca natyrore ose shoqërore. Lëndët mund të përfshijnë përvoja laboratorike.

**7. Perspektivat MATEMATIKORE (x2):** Lëndët përqendrohen në identifikimin dhe kuptimin e rolit që matematika luan në botë. Në këto lëndë, studentët kuptojnë dhe vlerësojnë informacione matematikore ose statistikore dhe kryejnë operacione matematikore të nivelit të kolegjit në të dhënat sasiore.

## **ARSIMI I PËRGJITHSHËM (ose SHKENCAT SOCIALE) (vazhdim)**

- C. Kërkesat zgjedhore për arte dhe shkencë (18 kredite semestrale)**
- D. Kërkesat e lira zgjedhore (9 kredite semestrale)**
- E. Kërkesat në komunikim (3 kredite semestrale)**

Kredite e mbetura zgjedhore të arsimit të përgjithshëm mund të specifikohen në programe akademike ashtu që studentët t'i përmbushin kërkesat mbështetëse (p.sh. matematikë ose shkencë, gjuhë të huaja, etj.). Disa nga këto kredite do të jenë lëndë të lira zgjedhore të arsimit të përgjithshëm që mund të zgjidhen nga vetë studentët. Kreditet në kategorinë e perspektivave që tërëtojnë kërkesën minimale do të zbatohen në drejtim të kredive zgjedhore.

### **Lëndët:**

ANTH-102	Antropologji kulturore	3 kredite
CMDS-499	CO-OP: Arte dhe shkenca aplikative	3 kredite
CMDS-500	Senior Capstone	3 kredite
CMDS-510	Jeta multidisiplinare	3 kredite
COMM-201	Të folurit publik	3 kredite
COMM-223	Dizajn digjital në komunikim	3 kredite
ENGL-210	Literaturë, kulturë dhe media	3 kredite
ENGL-216	Literaturë nga e tërë bota	3 kredite
ENGL-360	Argumente të shkruara	3 kredite
FNRT-100	Hyrje në arte vizuale	3 kredite
FRNT-370	Pikturë amerikane	3 kredite
MTSC-111	Matematikë ndërdisiplinore I	3 kredite
MTSC-112	Matematikë ndërdisiplinore II	3 kredite
MTSC-211	Hyrje në statistikë I	3 kredite
MTSC-212	Hyrje në statistikë II	3 kredite
MTSC-231	Shkencë bashkëkohore: Biologji	3 kredite
MTSC-232	Shkencë bashkëkohore: Kimi	3 kredite
PSYC-101	Hyrje në psikologji	3 kredite
TCOM-361	Teknikat e hulumtimit	3 kredite
UWRT-150	Shkrimi i vitit të parë: Seminar shkrimi	3 kredite

\* Disa lëndë të obligueshmes paraqiten si zgjedhore në disiplina të Drejtimeve Kryesore apo Sekondare.

## **MUNDËSITË PËR STUDIME JASHTË VENDIT DHE TË KËMBIMIT**

1. RIT Global (këmbimet ndërmjet kampuseve të RIT): Studentët mund të shkojnë në kampusin kryesore për një apo dy semestra duke paguar pagesën e shkollimit të kampusit vendor. Shpenzimet e jetës janë shtesë (rreth \$7000).
2. Universiteti HAMK (Erasmus+ Këmbim): Dy studentë të RITK mund të studiojnë në Universitetin HAMK për një semestër. Në anën tjetër, RITK pranon dy studentë të HAMK.
3. Universiteti SciencePo: Njëjtë sikurse HAMK

\* *Mundësitë e tjera bazohen sipas aplikimeve individuale*

## **INFORMATA PËR TË DIPLOMUARIT**

Të dhëna të mbledhura për 709 të diplomuar

### **Statistikat e punësimit (2016/17)**

- 94.1 % Të punësuar
- 58.8% Sektori privat (8.7% kanë nisur biznese të tyre)
- 41.2% Joprivate (d.m.th. Qeveri, Agjenci, OJQ, etj.)

### **5.9% Të papunë**

- 67 studentë aktualisht janë duke ndjekur arsimin e mëtejshëm dhe nuk mund të punojnë

### **Pozitat e mbajtura nga të diplomuarit**

- 22.9% - Menaxhment i lartë
- 29.4% - Menaxhment i mesëm
- 14.7% - Menaxhment i linjës (Mbikëqyrës)
- 18.9% - Staf administrativ
- 14.1% - Të tjerë (hulumtim, mësimdhënie, menaxherë projektsh, etj.)

### **Niveli i pagave të të diplomuarve (në EURO)**

- 8.1% - 2001 apo më lartë
- 7.2% - 1501 - 2000
- 18.9% - 1001 - 1500
- 43.4% - 501 - 1000
- 20.4% - 251 - 500
- 2.0% - 170 - 250

### **Statistika të vazhdimit të arsimit (2016/17)**

#### **52.5% kanë ndjekur studime pasuniversitare**

- 4.2% - Studime të doktoratës
- 81.9% - Nivel Master
- 9.6% - Certifikata profesionale
- 4.2% - Të tjera (kryesisht akademi ushtarake për rastet e FSK-së)

RIT Kosovë (A.U.K) Programet Universitare Udhëzues i Shpejtë i Referencës

Pregaditur nga:

Zyra për Çështie Akademike  
e RIT Kosovo (A.U.K):

Daniel Cosentino,  
Zëvendës-President për Çështie Akademike  
Drejtor i Programeve të RIT

Albina Balidemaj Basha,  
Managjere e Zyrës për Çështie Akademike

Qendra për Media:

Rrezarta Xhaferi,  
Udhëheqëse e Qendrës për Media

Qershor 2017

